

Fleta e të dhënave të produktit
Botimi 24/07/2014
Nr. i identifikimit: 010302040010000038
Kodi: 06.04.020
Sika® MonoTop®-621 Evolution



EN 1504-2

13

2079

Sika® MonoTop®-621 Evolution

Llaç riparues një përbërësi për suvatim

Përshkrimi i produktit

Sika® MonoTop® 621 Evolution është një llaç i përforcuar me fibra gati për përdorim, me bazë binderash (elemente lidhëse) sintetikë të modifikuar me polimere, aditivë specifikë, fibra sintetike dhe agregate me granulometri të posaçme, me synim përmirësimin e vetive të llaçit. Ky formulim çon në një ndërkapje të shkëlqyer mbi nënshtresat heterogjene, edhe në prezencën e mbetjeve të bojërave me natyrë të ndryshme kimike. Sika® MonoTop® 621 Evolution disponohet në ngjyrë të bardhë dhe gri.

Përdorime

- Mbrojtje e sipërfaqes të betonit, sipas EN 1504-9 Parimet: 1: mbrojtja kundër depërtimit (veshje); 2: kontroll i lagështisë (veshje); 8: rritje e rezistivitetit (veshje).
- Rregullim i sipërfaqeve të betonit me defekte mbi sipërfaqe
- Suvatim sipërfaqeje pas aplikimit të llaçit riparues
- Suvatim sipërfaqeje mbi pllaka, mozaik, etj.
- Suvatim sipërfaqeje mbi nënshtresa të vjetra.

Karakteristika / Avantazhe

- Punueshmëri e shkëlqyer
- Pa plasaritje nga tkurrja
- I aplikueshëm edhe mbi nënshtresa që nuk janë përgatitur me fryrje rëre
- Sjellje tiksotropike e shkëlqyer
- Ndërkapje e mirë mbi shumëllojshmëri nënshtresash: edhe në ato të lyerat, pllaka, mozaik edhe nëse aplikohet në shtresa me trashësi të madhe
- Koeficient zgjerimi termik i ngjashëm me atë të betonit
- Vetë të larta hidroizolimi
- Ngjyrë të bardhë dhe gri: mundësi për të zgjedhur në aspektin e estetikës

Testime

Miratime / Standarde

Llaç prej 1 përbërësi, i përforcuar me fibra dhe bazë çimentoje për mbrojtjen e sipërfaqes sipas kërkesave të EN 1504-2, Parimi 1,2 dhe 8 –Metodat 1.3, 2.2, 8.2 e EN 1504-9. Pajtohet me Aneksin ZA, Tabela ZA.1.

DoP 020302040010000038 1022, certifikuar nga Organi i Kontrollit të Prodhimit në Fabrikë, 0546, dhe i pajisur me shenjën CE.

Të dhënat e produktit

Forma

Paraqitja / Ngjyra

Pluhur, gri e lehtë, i bardhë

Ambalazhi

thes 25 kg



Magazinimi

Kushtet e magazinimit / Jetëgjatësia 12 muaj nga data e prodhimit nëse magazinohet saktë në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe të freskëta.

Të dhëna teknike

Baza kimike Çimento e modifikuar me polimere, agregate të përzgjedhura, mikrosilic dhe fibra

Dendësia E bardhë: ~ 1,8 – 1,9 kg/l
Gri: ~ 1,9 – 2,0 kg/l

Granulometria D_{max} : 0,5 mm

Të dhëna mekanike (Sika® MonoTop®-621 Evolution Gri)

Rezistenca ndaj kompresionit (EN 196-1)	1 ditë	7 ditë	28 ditë
		≥ 6 N/mm ²	≥ 20 N/mm ²

Kërkesat sipas EN 1504-2 (raporti ujë/pluhur materiali 18%)

	Metoda e testimit	Rezultati	Kërkesat
Përshkueshmëria e CO₂	EN 1062-6	$S_D = 67$	$S_D > 50$
Përshkueshmëria e avullit të ujit			Class I $S_D < 5$ m (i përshkueshëm) Class II $5 \text{ m} < S_D < 50$ m Class III $S_D > 50$ m (i papërshkueshëm)
	EN ISO 7783	$S_D = 0,11$ (Class I)	
Absorbueshmëria kapilare dhe përshkueshmëria e ujit të lëngshëm	EN 1062-3	$0,034 \text{ kg/m}^2 \times \sqrt{h}$	$w < 0,1 \text{ kg/m}^2 \times \sqrt{h}$
Cikli ngrirje-shkrirje (zhytje në kripë për shkrirje akulli)	EN 13687-1	$3,16 \text{ N/mm}^2$	$\geq 0,8 \text{ N/mm}^2$
Ndërkapja	EN 1542	$2,75 \text{ N/mm}^2$	$\geq 0,8 \text{ N/mm}^2$
Substanca të rrezikshme (Chromium VI)	EN 196-10	$< 0,0002\%$	$< 0,0002\%$
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A1	Euroclass

Të dhëna mekanike (Sika® MonoTop®-621 Evolution e bardhë)

Rezistenca ndaj kompresionit (EN 196-1)	1 ditë	7 ditë	28 ditë
		≥ 8 N/mm ²	≥ 15 N/mm ²

Kërkesat sipas EN 1504-2 (raporti ujë/pluhur materiali 20%)

	Metoda e testimit	Rezultati	Kërkesat
Përshkueshmëria e CO₂	EN 1062-6	$S_D = 68$	$S_D > 50$
Përshkueshmëria e avullit të ujit			Class I $S_D < 5$ m (i përshkueshëm) Class II $5 \text{ m} < S_D < 50$ m Class III $S_D > 50$ m (i papërshkueshëm)
	EN ISO 7783	$S_D = 0,10$ (Class I)	
Absorbueshmëria kapilare dhe përshkueshmëria e ujit të lëngshëm	EN 1062-3	$0,033 \text{ kg/m}^2 \times \sqrt{h}$	$w < 0,1 \text{ kg/m}^2 \times \sqrt{h}$

Cikli ngrirje-shkrirje (zhytje në kripë për shkrirje akulli)	EN 13687-1	2,40 N/mm ²	≥ 0,8 N/mm ²
Ndërkapja	EN 1542	2,98 N/mm ²	≥ 0,8 N/mm ²
Substanca të rrezikshme (Chromium VI)	EN 196-10	< 0,0002%	< 0,0002%
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A2	Euroclass

Informacione mbi sistemin

Detaje aplikimi

Konsumimi	Sa për udhëzim 2 kg/m ² / mm, në varësi të ashpërsisë së nënshtresës
Cilësia e nënshtresës	<p><i>Betoni:</i></p> <p>Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme dhe të jetë pa pluhur, pislëqe, materiale të lira, pellg uji dhe kontaminues sipërfaqësorë si vaj, graso dhe kore çimentoje.</p> <p><i>Nënshtresa të tjera:</i></p> <p>Nënshtresa duhet të ketë rezistencë mekanike, teksturë të hapur dhe të mos ketë pluhur, pislëqe, materiale të lira, pellg uji dhe kontaminues sipërfaqësorë si vaj, graso dhe kore çimentoje.</p>

Përgatitja e nënshtresës / Lyerja me prajmer

Beton ose llaç:

Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme mekanike, si curril uji me presion të lartë ose përpunim me rrymë rëre. Preferohen metoda pa vibrim/ tronditje. Betoni i dëmtuar, i shpetëzuar ose i dobët duhet të riparohet me llaçet SikaRep® ose Sika® MonoTop®.

Lagni sipërfaqen paraprakisht deri në saturim. Sipërfaqja e lagur duhet të arrijë një paraqitje mat të errët, pa shkëlqim: nuk duhet të ketë pellg uji mbi sipërfaqe.

Aplikime jo të rregulluara me EN 1504:

Sika® MonoTop® -621 Evolution nuk kërkon përgatitje të veçantë të nënshtresës. Duhet bërë investigimi i përgjithshëm i nënshtresës, për të hequr çdo grimcë të lirë ose grimcë me ndërkapje të dobët. Lagni sipërfaqen paraprakisht deri në saturim. Sipërfaqja e lagur duhet të arrijë një paraqitje mat të errët, pa shkëlqim: nuk duhet të ketë pellg uji mbi sipërfaqe.

Kushtet e aplikimit / Kufizime

Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.
Temperatura e ambientit	+5°C min. / +35°C max.

Udhëzime aplikimi

Raporti i përzjerjes	Gri: ~ 5 lt ujë për 25 kg pluhur I bardhë: ~ 4,75 lt ujë për 25 kg pluhur
Përzjerja	Sika® MonoTop® -621 Evolution mund të përzihet me një përzierës elektrik në shpejtësi të ulët (~ 500 r.p.m.). Në sasi të vogla llaçi mund të përzihet edhe mekanikisht. Hidhni ujin në proporcionin e saktë brenda një ene të përshtatshme për përzjerje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin tek uji. Përzieni plotësisht për të paktën 3 minuta, derisa të arrihet një konsistencë homogjene dhe pa kokrriza.
Metoda e aplikimit	<p>Aplikoni Sika® MonoTop® -621 Evolution me anë të një shpatulle tek nënshtresa që është njomur deri në saturim, duke ushtruar mirë presion mbi nënshtresë.</p> <p>Maksimumi i trashësisë së shtresës është 5 mm.</p> <p>Një përfundim i mirë i sipërfaqes mund të arrihet duke përdorur një dërrasë (mund të përdoret edhe metal) të gjatë e të sheshtë (floater) të veshur me sfungjer sapo llaçi të fillojë të ngurtësohet.</p>

Mirëmbajtja e mjeteve	Heqja e mbetjeve të freskëta nga pajisja dhe mjetet e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.
Koha e punueshmërisë në +20°C	~ 60 min
Trajtimi	Mbroni llaçin e freskët të aplikuar nga dehidratimi i hershëm duke përdorur metoda të përshtatshme trajtimi.
Shenime mbi aplikimin / Kufizime	<ul style="list-style-type: none"> ■ Sika® MonoTop® -621 Evolution siguron një ndërkapje të shkëlqyer mbi nënshtresë. Gjithsesi, preferohet kryerja e një testi të ndërkapjes mbi nënshtresat me veshje/ suvatime të vjetra ose që nuk janë përgatitur me metodat e zakonshme (përpunim me rrymë rëre etj.) ■ Rekomandohet rigorozisht kryerja e një testimi paraprak të ngjitjes mbi pllakat e vjetra ose mozaik. ■ Mos shtoni çimento ose substanca të tjera të cilat mund të ndikojnë tek vetitë e llaçit. ■ Mos shtoni ujë ose llaç të freskët në një përzierje llaçi e cila ka filluar të mpikset ■ Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ ose erë të fortë
Baza e vlerave të matshme	Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.
Kufizime lokale	Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për përshkrimin e saktë të fushave të aplikimit.
Informacione mbi shëndetin dhe sigurinë	Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit të sigurt, maganizimit dhe asgjësimit të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen botimit më të fundit të fletës me të dhënat e sigurisë (Safety Data Sheet, SDS), e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike, etj. rreth sigurisë gjatë përdorimit të produktit.
Shënime ligjore	Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të SIKA-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e SIKA-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. SIKA ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.



Sika Albania SHPK
 Rruga Ibrahim Rugova,
 Sky Tower, Building no. 5,
 9th floor, Office 91,
 Tiranë, Albania.

Tel.: +355 4 454 0070
 Email: info@al.sika.com
 alb.sika.com